

**VENDIM**  
**Nr. 384, datë 30.6.2021**

**PËR FORMËN E KOMUNIKIMIT NË PROCEDURAT E PROKURIMIT PUBLIK<sup>1</sup>**  
*(ndryshuar me vendimin nr. 22, datë 18.1.2023)*

*(I përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në procedurat e prokurimit “Dialog konkurrues”, “Partneritet për inovacion”, “Konkurruese me negocim”, fazat vijuese, pas fazës së parakualifikimit, zhvillohen në formë shkresore.

*1.1 Për procedurën e prokurimit “Konkurs projektimi”, fazat nga dorëzimi i kërkesave për shprehje interesi e në vijim zhvillohen në formë shkresore.*

2. Ngarkohen të gjitha autoritetet dhe entet kontraktore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Erion Braçe**

---

<sup>1</sup> Ky projektvendim është përafuar pjesërisht me:

- Direktivën 2014/24/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 shkurt 2014, “Mbi prokurimin publik dhe që shfuqizon direktivën 2014/18/KE”, të ndryshuar, me numër CELEX 32014L0024, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 94, datë 28.3.2014, faqe 65–242;

- Direktivën 2014/25/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 shkurt 2014, “Për prokurimin nga entitete që operojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare dhe që shfuqizon direktivën 2004/17/KE”, të ndryshuar, me numër CELEX 32014L0025, Fletore Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, numër 94, datë 28.3.2014, faqe 243–374.